7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f)Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.	Detergjent rrobash	13 200			
2.	Solucion larës enësh	11 000			
3.	Sfungjer enësh	5 000			
4	Tel enësh	3 500			
5	Qese mbeturinash plasmasi	3 300			
6	Peceta pastrimi	3 300			
7	Solucion, zbardhues, dizifektues	6 000			
8	llaç xhamash (me sprucator)	3 000			
9	Solucion pllakash	4 400			
10	Doreza pastrimi	3 000			
11	Sapun rrobash	700			
12	Sapun tualeti	990			
13	Kova (me mekanizem shtrydhje)	1 100			
14	Fshesa me bisht	1 000			

15	Shtupa me bisht	3 000			
16	Solucion për pastrim sobave	770			
17	Solucion parketi	3 000			
18	Leter higjenike	8 000			
19	Peceta duarsh (kartopeceta)	65 000			
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike të materialeve të pastrimit.

1. Detergjentë larës për rroba.

Kërkohet të jetë cilësor, aktiv, me fuqi larëse zbardhuese, për larje me lavatriçe. Të jetë I përshtatshëm për larjen e rrobave të bardha dhe të atyre me ngjyra. Të heqë njollat dhe papastërtitë. Kërkesat cilësore të pluhurit larës për rroba janë si më poshtë:

- | | |
|---|-----------------------------|
| 1- Densiteti (pesha e litrit): | Jo më pak se 800 gr/liter |
| 2- Permbajtja e joneve: | H ⁺ pH 10-11 |
| 3- Tretshmeria ne uje: | Jo më pak se 99 % |
| 4- Permbajtja e lageshtires: | Jo më shumë se 1.5 % |
| 5- Aroma: | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- Permbajtja e lendeve tensioaktive: | 10-15 % |
| 7- Aftesia shkumuese | 2.5-3.0 cm |
| 8- Përmbajtja e perboratit te natriumit | 10-11% |
| 9- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në qese plastike dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës. | |

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

- | | |
|------------------------------|----------|
| 10- Pesha e një konfeksioni: | 2 - 3 kg |
|------------------------------|----------|

2. Solucion larës enësh

Solucion lëng viskoz për larjen e enëve. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrave. Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të solucionit për larje:

- | | |
|---|------------------------------|
| 1- Densiteti: | 1.0 – 1.1 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 6.5-7.5 |
| 3- Tretshmeria ne uje | 100% |
| 4- Aroma: | Pak aromë. |
| 5- Konsistenca e solucionit: | Lëng viskoz |
| 6- Permbajtja e lëndëve tensioaktive | 29-31 % |
| 7- Viskoziteti | 1750 (±250)cp |
| 8- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në shishe plastike me grykë të ngushtë që lejon daljen me vështirësi të solucionit dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës. | |

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.
Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

9- Konfeksioni: 0.5 – 1 kg

3. Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH)

Të jetë aktiv, me fuqi larëse të njollave dhe papastërtive në pllaka, të jetë aromatic.
Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- 1- Densiteti: 0.95 - 1.00 gr/cm³
- 2- Permbajtja e joneve: pH 7-8
- 3- Tretshmeria ne uje: 100%
- 4- Paraqitja fizike e solucionit: Lëng viskoz, homogjen.
- 5- Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
- 6- Permbajtja e lendeve tensioaktive: 4.8 - 5 %
- 7- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në bidon plastik dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.
Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

8- Konfeksioni: 1- 5 litër

4. Sapun tualeti

Të shkumëzojë mire në ujë të ngrohtë dhe të ftohtë me fortësi normale. Shkuma të jetë e qëndrueshme, të mos jetë ngjitëse dhe gjatë përdorimit të mos copëtohet.

Erë e këndshme, parfumi.

Kërkesat specifike të jenë si më poshtë:

- 1- Densiteti 1 – 1.05 g/cm³
- 2- Përmbajtja e joneve PH 6-7
- 3- Tretshmëria 98%-100%
- 4- Pamja fizike Sapun kallëp i ngurtë.
- 5- Ngjyra e sapunit: Me ngjyra të ndryshme.
- 6- Pesha e sapunit 80-90 gr.
- 7- Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
- 8- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në letër ku të jetë përcaktuar emërtimi dhe kodi i prodhuesit.

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.
Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

5. Solucion për larje xHAMASH

Solucion larës xhamash, me efekt pastrimi të njollave dhe pluhurave në xhama.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

1. Densiteti: 0.98-1.0 gr/cm³
2. Permbajtja e joneve: pH 6-7
3. Tretshmëria 100%
4. Paraqitja fizike e solucionit: Solucion homogjen, lëng i pastër.
5. Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
6. Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastik me sprucator dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikës.

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

7. Konfeksioni: 0.5 - 1 liter

6. Solucion për pastrimin e sobave

Produkti të jetë profesional me përdorim të gjerë kundra yndyrës dhe i përshtatshëm për pastrimin e sobave të kuzhinës. I tretshëm në ujë dhe jo i dëmshëm për lëkurën e njeriut. Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|---|
| 1- Densiteti | 0.98-1.025 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 10-11 |
| 3- Tretshmeria ne uje: | 100% |
| 4- Paraqitja fizike e solucionit: | Solucion homogjen. |
| 5- Aroma | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- Ambalazhimi: | Ambalazhim fabrike ne bidon plastik me sprucator dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikës. |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

7- Konfeksioni: 0.5 - 1 litër

7. Solucion zbardhues, dizinfektues rrobash

Kërkohet të ketë veti të mira zbardhuese dhe dezinfektuese.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1- Densiteti: | 1.04 - 1.066 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 12.5-14 |
| 3- Tretshmeria ne uje: | 100% |
| 4- Permbajtja e klorit | 3.8 - 4 % |
| 5- Aroma: | Aromë shpuese e klorit. |
| 6- Ngjyra: | Transparente, jeshile ose e verdhë. |
| 7- Ambalazhimi: | Ambalazhim fabrike ne shishe plastike dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikes. |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

8- Konfeksioni: 2 - 2.5 Litra.

8. Shtupa me bisht për larje dyshemeje.

Shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit.

Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës.

Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

9. Fshesa pastrimi me bisht.

Fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme.

Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës.
Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

10. Qese plastmase për mbeturina

Te jenë rezistente, plastike, me përmasa 70x100 cm
Paketim në formë ruloje.
Pakoja të ketë 10 fije (qeska).

11. Sapuni i rrobave

Të jetë cilësor për larje rrobash dhe të heqë papastërtitë.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

1. Gjendja fizike: Sapun kallëp i ngurtë.
2. Ngjyra: E bardhë.
3. Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
4. Densiteti: 1.1 - 1.2 gr/cm³
5. Përmbajtja e joneve: pH 6 - 7
6. Tretshmëria në ujë 98 – 100 %
7. Lartësia shkumuese 2.5 - 2.7 cm
8. Peshë e sapunit/copë 125 -130 gr
9. Ambalazhimi: Sapuni të jetë i pakeluar me ambalazhim fabrike me qeske plastmase të tejdukshme ku të jetë përcaktuar të dhënat e prodhuesit dhe kodi I fabrikes.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit të produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

12. Peceta pastrimi për tavolinat

Të jenë cilësore. Të jenë të ambalazuara nga fabrika në pako. Çdo pako të përmbajë 3 copë.

Të jenë të forta dhe të lahen me ujë.

Pecetat duhet të kenë përmasat:

Gjerësi 36-40 cm

Gjatësi 38-42cm.

13. Doreza plastike

Të jenë rezistente për përdorim për larje muri e pllakash me nr. 7-8-9. Të jenë elastike në përdorim. Material latex, cilësor dhe me ngjyra të ndryshme.

Të jenë të paketuara me ambalazhin e fabrikës ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

14. Sfungjer enësh

Të jenë nga njëra anë me fibër të fortë abrasive për pastrim sipërfaqesh të ashpra dhe nga ana tjetër sfungjer me pore të vogla.

Anësore të jenë me kanal për mbrojtjen e thonjëve.

Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

15. Tel për pastrim enësh

Të jene të një madhësie mesatare, me përmbajtje inoxi, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi dhe të dhënat e prodhuesit dhe me paketim çdo copë më vete ose paketime me jo më shumë se tre copë.

16. Kova plastike

Të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërsh, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatin shtrydhës për shtrydhjen e shtupës.

Të jetë material plastik i forte, i plotë dhe pesha totale e kovës së bashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr.

17. Solucion parketi

Solucioni për pastrim parketi të jetë me aromë të mirë dhe me aftësi heqjen e njollave dhe shkëlqimin e sipërfaqeve të shtruara me parket.

Specifikimet teknike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1- Densiteti | 0.95 – 1.005 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 7 - 8 |
| 3- Tretshmeria në ujë | 100% |
| 4- Paraqitja fizike | Solucion homogjen viskoz i pastër. |
| 5- Aroma | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në bidon plastik dhe të përmbajë kodin e prodhimit të fabrikës. | |

Data e skadencës jo më pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit të produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2022.

- | | |
|----------------|----------------|
| 7- Konfeksioni | 0.75 - 5 litra |
|----------------|----------------|

18. Peceta duarsh (kartopeceta)

Peceta e duarve do të shërbejnë për pastrimin e duarve pas ushqimit. Ato duhet të jenë cilësore.

Përmasat e pecetës së hapur duhet të jenë si më poshtë:

Gjerësi: 28-30 cm

Gjatësi: 28-30 cm

Pesha specifike e pakos me peceta: 130-150 gr.

Paketim i përbërë nga jo më pak 70 fije peceta për 1 pako.

Përbërja: 100% celulozë

Ngjyra: Plotësisht e bardhë

Të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, përmasat e pecetës, pesha specifike (neto) e pakos, numri i fijeve të pakos dhe përbërja.

19. Letër higjenike

Letrat higjenike duhet të jenë cilësore.

Ato duhet të jenë “rulonë” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulonë secila.

Çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa:

Gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm

Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm

Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa.

Pesha specifike e një ruloni: 100-150 gr

Përbërja: 100% celulozë.

Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një ruloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një ruloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.

Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike

Për përgatitjen e specifikimeve teknike, komisioni i është referuar Ligjit nr. Nr. 10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM nr. Nr.669, datë 28.9.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët”.

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre.

Duke iu referuar nevojave specifike të çerdheve dhe kopshteve në funksion të shërbimit të pastrimit cilësor, për të cilin shërbejnë këto materiale, nga gjithë shumëllojshmëria e artikujve të ngjashëm, të markava të ndryshme tregëtare, që gjenden në treg, janë përzgjedhur ata artikuj të cilët kanë karakteristika të njëjta edhe pse janë të markave tregëtare të ndryshme por që në raport me çmimin dhe specifikimet përkatëse për secilin prej tyre, plotësojnë më së miri si nga ana cilësore por edhe nga ana sasimore këtë shërbim, i cili merr një rëndësi të veçantë përderisa është në funksion të çerdheve dhe kopshteve si qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Për sa i përket konfeksioneve të përcaktuara për secilin artikull, janë lënë hapësirat e nevojshme minimale dhe maksimale, referuar paketimeve që gjenden në treg, por duke patur gjithmonë parasysh që ato të jenë në funksion të realizimit sa më praktik dhe funksional të procesit të shpërndarjes së këtyre produkteve nëpër çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, si dhe në funksion të procesit të magazinimit.

Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasimore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specifikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucione, është e nevojshme të sqarojmë se;

- *Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material I huaj është I përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.*

- *Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve H^+) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentit pluhur, dhe solucione për pastrimin e sobave, zbardhues dezinfektues rrobash, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.*

- *Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.*

- *Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).*

- *Substancat teksoaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërëse të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrofille dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsione ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.*

-
- **Sqarim për shtojcën 5:** Referuar përcaktimeve si “*me aromë të mirë, të lehtë*” në disa produkte objekt prokurimi sqarojmë se, duke qënë se këto produkte janë parashikuar të përdoren në ambjente rezidenciale të frekuentuara nga fëmijë të moshave 6 muaj – 6 vjeç (çerdhe dhe kopshte) këshillohet që aromat e tyre të jenë sa më të lehta dhe të këndshme me ndjeshmëri sa më të ulët në shqisën e të nuhaturit të fëmijëve. Gjithashtu sqarojmë se AK, në zbatim të parimeve të përcaktuara në LPP, me qëllim që mos të shmanget apo ngushtojë konkurrencën në këtë procedurë prokurimi, nuk ka përcaktuar aroma specifike (aroma konkrete si psh lulesh, frutash, bimësh etj), por ka konsideruar që përcaktimi “*e mirë*” dhe “*e lehtë*” është gjithpërfshirës.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia totale e mallit që do të lëvrohet është sipas listës së mëposhtme.

Malli do të lëvrohet me kërkesën e Autoritetit Kontraktor.

Lëvrimi i malli parashikohet të kryhet çdo 60 ditë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të kontrates, deri në 31.12.2022, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor 20 ditë përpara lëvrimit.

Sasia e mallit që do të lëvrohet do të përcaktohet në kërkesën e Autoritetit Kontraktor, duke patur parasysh nevojat e çerdheve dhe kopshteve në zbatim të normativave të miratuara, frekuentimit, si dhe kapacitetit magazinues të AK.

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia	Parashikim për grafikun e lëvrimit
1	Detergjent rrobash	kg	13,200	31.12.2022
2	Solucion larës enësh	kg	11,000	31.12.2022
3	Sfungjer enësh	copë	5,000	31.12.2022
4	Tel enësh	copë	3,500	31.12.2022
5	Qese mbeturinash plasmasi	pako	3,300	31.12.2022
6	Peceta pastrimi	copë	3,300	31.12.2022
7	Solucion, zbardhues, dizifektues	litra	6,000	31.12.2022
8	llaç xhamash (me sprucator)	litra	3,000	31.12.2022
9	Solucion pllakash	litra	4,400	31.12.2022
10	Doreza pastrimi	palë	3,000	31.12.2022
11	Sapun rrobash	kg	700	31.12.2022
12	Sapun tualeti	kg	990	31.12.2022
13	Kova (me mekanizem shtrydhje)	copë	1,100	31.12.2022
14	Fshesa me bisht	copë	1,000	31.12.2022
15	Shtupa me bisht	copë	3,000	31.12.2022
16	Solucion për pastrim sobave	litra	770	31.12.2022
17	Solucion parketi	litra	3,000	31.12.2022
18	Leter higjenike	pako	8,000	31.12.2022
19	Peceta duarsh (kartopeceta)	pako	65,000	31.12.2022

Argumentim për grafikun e lëvrimit:

Përcaktimi i sasisë së nevojshme vjetore të materialeve të pastrimit në DPÇK, bëhet duke iu referuar normativave orientuese të miratuara të institucionit për përdorimin e tyre.

Sasia e nevojshme për furnizimin me materiale pastrimi për çdo çerdhe apo kopësht, llogaritet duke iu referuar nevojave të secilës prej tyre në zbatim normativave të miratuara për konsum.

Nevojat e çerdheve apo kopshteve në periudha të ndryshme të vitit janë të ndryshme për arsye të ndryshimit të numrit të fëmijëve që frekuentojnë.

Refruar këtyre llogaritjeve, AK do të paraqesë kërkesën për materiale pastrimi të nevojshme çdo 60 ditë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke shfrytëzuar edhe kapacitetet magazinuese, në mënyrë që të plotësojë në çdo rast nevojat e të gjitha çerdheve dhe kopshteve.

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit të mallrave do të jetë që nga data e lidhjes së kontratës deri 31.12.2022.

Kushtet e lëvrimit

Malli do të lëvrohet pranë magazinës së Autoritetit Kontraktor.

Transporti i mallit deri në magazinën e Autoritetit Kontraktor do të kryhet me automjetet e subjektit kontraktor nga ora 08:00 – 14:00

Dorëzimi i mallit do të kryhet në prani të komisionit të DPÇK dhe përfaqësuesit të autorizuar të subjektit kontraktor.

Prania e përfaqësuesit të autorizuar të subjektit kontraktor përbën kusht për marrjen e mallit në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Kopje të certifikuara të balanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese për vitet financiare 2020, 2021 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
 - Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
 - Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1 (një) mjet transporti** me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3 ton për transportin e

materialeve të pastrimit, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon **1 (një) mjet transporti** me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3 ton, ne pronësi ose ne përdorim sipas kontratës noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
 - çertifikate pronësie
 - siguracion (TPL)
 - çertifikatë e kontrollit teknik
- Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente dhe ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

2.3.4 Vetëm për produktet:

Nr	Emërtimi i produktit
1	Detergjent rrobash
2	Solucion larës enësh.
3	Solucion, zbardhues, dizifektues
4	Ilaç xhamash
5	Solucion pllakash
6	Sapun rrobash
7	Sapun tualeti
8	Solucion për pastrimin e sobave
9	Solucion parketi

OE duhet të paraqesë:

a) **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent.

Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike.

b) Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre.

Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara.

(Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuar)

2.3.5. Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njësuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licencuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njësuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

Argumentim për hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:

Për përgatitjen e kërkesave për kriteret e veçanta të kualifikimit, komisioni ka patur parasysh kërkesat për cilësinë dhe sigurinë e produkteve objekt prokurimi, si dhe sigurimit të transportit të këtyre produkteve nga ana e OE në momentin e lëvrimit.

- *Kriteri që OE duhet të paraqesë vetdeklarimin ku të deklarojë se disponon 1 (një) mjet transporti me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3 ton për transportin e materialeve të pastrimit është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës për procedurën e lëvrimit të mallrave. Mallrat do të lëvrohen nga OE pas kërkesës së AK në magazinën e AK, në kohë të ndryshme dhe me sasi të përcaktuara që do të llogariten herëpashere sipas nevojave të çerdheve dhe kopshteve si dhe sipas mundësisë së magazinimit. Përcaktimi i kapacitetit të automjetit të kërkuar “jo më pak se 3 ton” është vendosur duke patur parasysh sasinë, peshën dhe volumin e madh të materialeve të pastrimit që duhen lëvruar.*
- *Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, për tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin i menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton, nisur dhe nga fakti që produktet e prokuruar do të përdoren në ambjentet e çerdheve dhe kopshteve të cilat janë ambjente rezident për fëmijë të grupmoshës 6 muaj-6 vjeç.*
- *Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente me të për sistemin e menaxhimit të mjedisit, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin i menaxhimit të mjedisit” për produktet që ai tregëton. Duke*

marrë në konsideratë natyrën e produkteve që kërkohen (përbërësit kimik të tyre), natyrën e aktivitetit të operatorëve ekonomikë, si dhe lidhur ngushtë me kërkesat tona për cilësitë teknike të artikujve dhe ndikimin e tyre në mjedis, (kryesisht përsa i përket (detergjenteve të rrobave, solucionëve), është konsideruar e arsyeshme nga ana jonë kërkesa e këtij certifikimi.

- Kriteri që, për mostrat e tipit detergjentë, solucionet dhe sapunët, sipas listës së kërkuar, OE duhet të paraqesë Raport Analizë nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) ose laborator tjetër ekuivalent është vendosur që OE të vërtetojë që mostra e paraqitur, është analizuar dhe se plotëson të gjitha parametrat dhe treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.

- Kriteri që, për mostrat e tipit detergjentë, solucionet dhe sapunët, sipas listës së kërkuar, OE duhet të paraqesë skedën teknike dhe të sigurisë të produktit është vendosur si kërkesë e ligjit . Nr. 10216, datë 21.01.2010, “Për detergjentët” neni 9 pika 1, ku përcaktohet që: Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi, që vendos në treg detergjentet ose substancat tensioaktive në detergjente, ka detyrimin të kalojë informacionin e përgjithshëm për produktin përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit.

- Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 6/a. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE (dëshmit të raport analizave), për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:

Për përcaktimin e fondit limit, Komisioni është bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Për përcaktimin e fondit limit i është referuar Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për blerje materiale pastrimi për vitin 2022.
- Çmimi është përcaktuar nga mesatarja e çmimeve që del bazuar në Proces - Verbalin e Testimit të Tregut.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

--	--	--	--

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
